



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2024:184096

Datë: 30.09.2024

Numri i dokumentit: 06231664

P.nr.228/2024

NË EMËR TË POPOLLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Qemail Suka, me procesmbajtësen Vjollca Bytyqi, në çështjen penale kundër të akuzuarve B.G., nga fshati Peqan komuna e Suharekës, për shkak të veprës penale kanosja nga neni 181 par.4 lidhur me par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Kodi nr.06/L-074 dhe të akuzuarit A.G., nga fshati Peqan komuna e Suharekës, për shkak të veprës penale kanosja nga neni 181 par.4 lidhur me par.2 dhe veprës penale, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Kodi nr.06/L-074, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.1281-5/24 të datës 03.09.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, me datë 19.09.2024, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Besim Susuri të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre, av. Ruzhdi Gashi dhe av.Refki Gega, me datë 20.09.2024 mori, publikisht shpalli, ndërsa me datë 30.09.2024 përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

B.G., nga i ati dhe e ëmae vajzërisë, i lindur menë fshatin Peqan Komuna e Suharekës, ku edhe tani jeton, bujk, i pa martuar, ka të kryer shkollën fillore, me nr. personal, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovë, në paraburgim nga data, 30.06.2024 deri më 19.09.2024, dhe

A.G., nga i atie ëma, e lindur, i lindur më, nga fsh. Peqan komuna Suhareke, ku dhe tani jeton baba i 7 fëmijëve i gjendjes se dobët ekonomike, me pare i pa dënuar, shqiptar shtetas i republikës se Kosovës, me numër personal,

JANË FAJTOR

I akuzuari B.G.,

- I. Sepse nga data e pavërtetuar e deri me datë 30.06.2024 rreth orës 10:00 minuta, në fshatin Peqan, Komuna e Suharekës, saktësisht në shtëpinë e tyre të përbashkët, i pandehuri B.G., seriozisht e kanos me fjalë se do ta privoj nga jeta me qëllim të frikësimit personin tjetër të dëmtuarin, babanë e tij, A.G., i cili është viktimë e ndjeshme si person marrëdhënia e së cilit ndaj të pandehurit e bënë atë veçanërisht të ndjeshme ndaj viktimizimit të përsëritur, frikësimit të përsëritur, ashtu që si rrjedhojë e mosmarrëveshjeve të vazhdueshme mes tyre

si dhe si pasoj e problemeve psikike që ka i pandehuri, i njëjti vazhdimisht i drejtohet të dëmtuarit me fjalë kanosëse se “**ka me ju vra krejtve, ka me ju pre se nuk i besoj ma as vetes se çka muj me ba**”, me ç’ rast me këto veprime tek i dëmtuari A.G., ka shkaktuar frikë, ankth dhe pasiguri për jetë.

- Me këto veprime ka kryer veprën penale, kanosja nga neni 181 par.4 lidhur me par.2 të KPRK-së.

I akuzuari, A.G.,

II. Sepse me datë 30.06.2024 rreth orës 10:00 minuta, në fshatin Peqan, Komuna e Suharekës, saktësisht në shtëpinë e tyre të përbashkët, i pandehuri A.G., seriozisht e kanos me armë zjarri se do ti shkaktoj ndonjë të keqe me qëllim të frikësimit, personin tjetër të dëmtuarin, djalin e tij B.G.,n, i cili është viktimë e ndjeshme për shkak të marrëdhënies që ka me të pandehurin dhe për shkak të gjendjes shëndetësore psikike, ashtu që si rrjedhojë e mosmarrëveshjeve të vazhdueshme mes tyre, i pandehuri ditën kritike si pasojë e kanosjeve të vazhdueshme nga ana e të dëmtuarit, nxjerr armën e zjarrit të cilën e kishte me vete dhe shtënë me armë në drejtim të qiellit me qëllim që ta frikësoj të dëmtuarin, me ç’ rast me këto veprime tek i dëmtuari B.G., ka shkaktuar frikë, ankth dhe pasiguri për jetë.

- Me këto veprime ka kryer veprën penale, kanosja nga neni 181 par.4 lidhur me par.2 të KPRK-së.

III. Sepse me datë kohë dhe vend të njëjtë si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, i pandehuri A.G., mbanë në pronësi, kontrollon ose posedon armë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët, pistoletën e llojit 7.65 mm., prodhim i panjohur, ku i njëjti ditën kritike, për shkak të mosmarrëveshjeve të përshkruara si më lartë, që kishte me të dëmtuarin B.G., – djalin e tij, i pandehuri nxjerr armën dhe shtënë në drejtim të qiellit me qëllim që ta frikësoj.

- Me të çka ka kryer veprën penale, mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të paautorizuar te armeve nga neni 366 par 1 te KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 43, 46, 47, 48, 49, 69 të KPRK-së dhe nenit 364 të KPRK-së, të akuzuarve iu shqipton:

DËNIM ME KUSHT DHE DËNIM ME GJOBË

Të akuzuarit **B.G.**, ia cakton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin e verifikimit prej 2 (dy) viteve, nëse i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të cilin dënim në rast të revokimit të dënimin, duhet të llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga data, 30.06.2024 deri më 19.09.2024.

Te akuzuarit A.G.,

Për veprën penale sipas dispozitivit, nën II-të aktakuzës, Dënim me kusht, duke ia caktuar dënimin me burgim prej një (1) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i

akuzuari në kohën e verifikimit prej dy viteve nuk kryen veprë tjetër penale, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Sipas dispozitivit nën III-të aktakuzëa dënim me gjobë në lartësi prej 400 €,

Gjykata duke aplikuar dispozitat e nenit 76 për shqiptimin e dënimit për bashkim të veprave penale i shqipton:

DËNIM UNIK-DËNIM ME KUSHTE DHE DËNIM ME GJOBË

*Duke ia caktuar dënimin me burgim prej një (1) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në kohën e verifikimit prej një viti nuk kryen veprë tjetër penale dhe dënim me gjobë në lartësi prej 400 €, në të cilin dënim duhet të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga dt. **30.06.2024** deri me dt. **09.07.2024**, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.*

Bazuar në nenin 366 par. 3 të KPRK-së, të akuzuarit A.G., i konfiskohen, Një pistolet e kalibrit 7.65 mm, prodhim i panjohur pa nr.serik; Një karikator i pistoletës; dhe

Një fishek i kalibrit 7.65 mm.

Obligohen të akuzuarit që në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit ta paguaj shumën prej 20 euro secili veç e veç dhe në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 20 euro secili veç e veç, të gjitha këto pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën me numër PP/II.nr.1281-5/24 të datës 03.09.2024, kundër të akuzuarve B.G., nga fshati Peqan komuna e Suharekës, për shkak të veprës penale kanosja nga neni 181 par.4 lidhur me par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Kodi nr.06/L-074 dhe të akuzuarit A.G., nga fshati Peqan komuna e Suharekës, për shkak të veprës penale kanosja nga neni 181 par.4 lidhur me par.2 dhe veprës penale, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Kodi nr.06/L-074.

Pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit Besim Susuri, të akuzuarit kanë theksuar se e kanë kuptuar në tërësi akuzën dhe e kanë pranuar fajësinë në të gjitha pikat e aktakuzës dhe kanë deklaruar se e ndiejnë veten fajtor duke u penduar për veprat penale dhe duke u zotuar se vepra të tilla ose të ngjashme në të ardhmen nuk do të përsëriten. Prokurori i Shtetit nuk ka patur kundërshtime lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve.

Gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve pasi që i njëjti pranim është vullnetar dhe pa presion në kuptim të nenit 242 të KPPRK-së.

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor ka vërtetuar këtë gjendje faktike: si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjendjen e tillë faktike, gjykata e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë së të akuzuarve si dhe me administrimin e provave që gjinden në shkresat e lëndës dhe atë bëri leximin e: kallëzimit penal 2024-GB-368 dt. 30.029.2024, raportin e oficerit policor me numër të rastit 2024-GB-368 dt. 30.029.2024 të dhënë në Stacionin Policor në Suharekë, procesverbalin mbi

intervistimin e të pandehurve B.G., dhe A.G., i dt.30.06.2024 të dhënë në Stacionin Policor në Suharekë, dhe shkresave tjera në lëndës.

Sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit për veprat penale të cilat iu vihet në barrë e që pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare, pa kushtëzim dhe mbështetet në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat të akuzuarit kanë qenë të njoftuar me të gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhur në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve është bërë në pajtim me neni 242 të KPPRK-së dhe nga faktet që përmban aktakuza, në veprimet e akuzuarve formohen të gjitha elementet e veprave penale, të akuzuarit, B.G., veprës penale kanosja nga neni 181 par.4 lidhur me par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Kodi nr.06/L-074 dhe të akuzuarit A.G., veprës penale kanosja nga neni 181 par.4 lidhur me par.2 dhe veprës penale, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Kodi nr.06/L-074,

Me rastin e marrjes të vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 të KPPRK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke gjetur si rrethanë rënduese se të akuzuarit edhe më parë kanë kryer vepra penale, ndërsa si rrethanë lehtësuese gjykata vlerësoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve, pendimin e tyre të sinqertë dhe zotimin e tij se në të ardhmen nuk do të përsërisin vepra të tilla apo të ngjashme, andaj gjykata i shqiptoi dënimet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Me bindje se dënimet e shqiptuara i përgjigjen shkallës së përgjegjësisë së tyre penale dhe se me këto dënime do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jenë më i kujdesshëm dhe të përmbahen nga veprimet e tilla apo të ngjashme.

Gjykata kërkesën për shqiptimin e masës trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri, të akuzuarit B.G., nuk ia shqiptoi, sepse me aktgjykim të formës së prerë P.nr.64/22 të datës 09.03.2022, të njëjtit i është shqiptuar masa trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri,

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në kuptim të nenit 452 të KPPRK-së.

Vendimi me të cilin është i obliguar i akuzuari që të bëj kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 449 par. 2 pika 2.9 të KPPRK-së.

Nga të lartcekurat është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË
P.nr.228/2024të dt. 30.09.2024

G j y q t a r i
Qemail Suka

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 30 dite nga dita e pranimi, ankesa dorëzohet nëpërmjet të kësaj gjykate.